

Komuna e Mamushës

Data 31.08.2020

Mbledhja e 01 e Jashtëzakonshme e Komitetit për Komunitete

Vendi: Mamushë

PROCESVERBAL

Mbledhja e 01 e jashtëzakonshme e Komitetit për Komunitete është mbajtur me datë 31.08.2020 në ora 09:00 në zyrën e Kryesuesit të Kuvendit. Mbledhjen e ka udhëhequr Kryesuesja e kuvendit Znj. Albiona Sadiku.

Në mbledhje kanë marrë pjesë 5 anëtarë.

Albiona Sadiku:

Të nderuar anëtarë të Komitetit për Komunitete dhe pjesëmarrës tjerë mirë se erdhët në mbledhjen e 01 të jashtëzakonshme të komitetit për komunitete për vitin 2020. Mund t'ia fillojmë mbledhjes.

Rendi i dites:

1. **Transferi i rezervave në shumën 50.677.00€ ;**

Albiona Sadiku: (Kryesuese e Komitetit)

A ka dikush diçka me pyet në lidhje me këtë pikë, nëse jo atëherë fjalën ia japim ZKF-së, Znj. Xhevahire Rushiti ?

Xhevahire Rushiti

Përsëritet oher të gjithë, unë do të mundohem kadal dalë me fol. Rezervat janë prej vitit të kalum në mënyrë që me qenë më e qartë. Rezervat janë prej vitit të kalum, 'i kemi pas na totalin e pagave 1.136.000€ edhe i ka nda për secilin program shuma të caktuara, e total 50.677.00€ . Tash ligji në fillim të vitit që u bo po kërkon, aty e ka qit ni nen, nëse bohet ligji i ri i pagave qeto pare shkojnë te pagat. Kur u bo rihikimi i buxhetit parlamenti i Kosovës ka thënë që këto pare nuk guxojnë me shku në paga por për kapitale apo qysh i ka komuna nevojat. Tash qeto 50.000€ edhe diçka te Arsimit, shembull Arsimit mujna mi nimu ama paret smujna me ja marrë. Prej qati totali 9.389.00€ janë shku te arsimi fillor, per mallra dhe shërbime se Arsimit ka nevojë, dru, tani banvaki ka nevojë edhe me dezinfektu objektet e shkollave, e qaty i kemi planifiku. Pjesën tjetër të totalit në dy projekte kanë shku 9.851.00€ te projekti i trafos edhe mirembajtja e rrugëve dhe kanaleve të hapura 31.437.00€, edhe për qeto ministria ka thonë që nuk keni drejt me bo ndonjë projekt të ri që su kon deri tash, vetëm projektet ekzistuese. Qekjo është për rezervën shtetërore.

Albiona Sadiku: (Kryesuese e Komitetit)

Faleminderit Znj. Xhevahire Rushiti, a ka dikush diçka me pyet në lidhje me këtë pikë, nëse jo atëherë fjalën ia japim Drejtorit të Financave Z. Turker Mazrek?

Turker Mazrek:

Përsëritet për të gjithë, na i kemi pas disa rezerva të buxhetit të vitin të kaluar që i kemi votuar për këtë vit dhe ky buxhet ka qenë nëse hyn në fuqi ligji i ri i pagave por pasi që ligji i ri i pagave nuk ka hy në fuqi këto rezerva për mos me shku suficid ne po i transferojmë në projekte të ndryshme ekzistuese. Ne kemi menduar që këto mjete ti transferojmë në dy projekte, njëri projekt është për trafo elektrike 10.000€ por ministria nuk po lejon të transferohen në projekte të reja kurse projekti tjetër për Arsim, kurse pjesa e mbetur për projekte infrastrukturore.

Albiona Sadiku: (Kryesuese e Komitetit)

Faleminderit. A ka dikush diçka me shtu në lidhje me këtë pikë?
Xhevahire Rushiti

Edhe diçka deshta me thënë, nëse na qeto pare nuk i bëjmë transfer na merr Qeveria mrapa edhe mo nuk kthehen, domethënë shkojna hupsa e pse mos me i shfrytëzu, kemi fol me komunat tjera edhe ato krejt i kanë transferu.

Albijona Sadiku:(Kryesuese e Komitetit)

Faleminderit. A ka dikush diçka me shtu në lidhje me këtë pikë ,nëse jo atëherë votojmë.

-po(5)

-jo(0)

-abstenim(0)

Me vota unanime ky transfer u miratua.

Të nderuar pjesmarrës nëse nuk keni diçka për të shtuar atëherë mbledhja e sotme ka përfunduar.Faleminderit për pjesëmarrje.

Shënim mbajtësi
Idriz Mazrek

Kryesuesja e Komitetit për Komunitete
Albijona Sadiku

